



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1156/1 Prot

Rrëshen më, 26 . 03 . 2025

V E N D I M

Nr. 26 datë 25. 03. 2025

**PËR
“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit 2025", VKB nr. 115, datë 27.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", relacionin nr. 776/1 prot, datë 28.02.2025, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Znj. Luljeta Nikoll Gjoka", nga Drejtoria e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Ekonomike, së bashku me projektin e Kryetarit bashkisë, këshilli bashkiak pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën **120 000 lekë**, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;...**120 000 lekë**
 - b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....**120 000 lekë**
2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



KRYETAR

Aleksandër PICAË

tel dhe fax (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 1156 Prot

Datë 17/03 / 2025

P/V E N D I M
Nr. 30 date 17.03 .2025

“PËR PERDORIM FOND REZERVË ”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ne ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjit nr.115/2024, “Per buxhetin e vitit 2025” “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në udhëzimin nr.1, datë.24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit 2024”, ,ne VKB nr.115 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, në relacionin, nr.776/lprot, datë.28.02.2025, “Mbi vlesimin e situates financiare dhe sociale te z.Luljeta Gjoka”, e sektorit të shërbimit social, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

V E N D O S I:

I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 50 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;

1.Të japë ndihmë financiare, z Luljeta Gjoka., NJA Rreshen, për kushte të vështira jetese.

a-Paksim:fondi rezervë (AI133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën **50 000 lekë**

b-Shtohet (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën **50 000 lekë**

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen.

II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise.

III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: M. Doda

KRYETARI
Albert MËLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a





BASHKIA MIRDITË

AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr. 776 / Prot.

Rrëshen, më 28.02.2025

Lënda: Relacion

Drejtuar: Drejtorisë së Financës së Bashkisë Mirditë

Lidhur me shkresën e ardhur në Bashkinë Mirditë më 19.02.2025, me nr.prot. 776 ardhur nga Njësia Administrative Fan për rastin e familjes së Zj. Luljeta Lekë Gjoka, ju japim relacionin si më poshtë:

Zj. Luljeta Gjoka, e lindur në Srriqe të Pukës më 16.06.1980, me NID I05616046I jeton me të bijën 9 vjeç dhe vjehrrën. Në certifikatë familjare është vetëm me të bijën. Tre muaj më parë ka mbetur e vejë, pasi i shoqi Z. Mark Ndue Gjoka ka ndërruar jetë në shkaqe aksidentale në vendin e punës. Gjendja ekonomike e familjes është bërë tepër e vështirë, pasi kryefamiljari ishte i vetmi që punonte. Zj. Luljeta është e sëmurë dhe e paaftë për punë. Të ardhurat financiare të familjes vijnë vetëm nga PAK, ku ajo është e diagnostikuar me Astmë Bronkiale persistente formë e rëndë dhe SPOK formë e rëndë dhe përfiton shumën prej 11 652 lekë, shumë e pamjaftueshme për të përballuar jetësën, me gjithë detyrimet dhe nevojat që ka familja. Gjithashtu, edhe gjendja psikologjike e Luljetës dhe e vajzës është rënduar, për shkak të humbjes së kryefamiljarit.

Për këtë, edhe ne si Shërbim Social i Bashkisë Mirditë, e vlerësojmë të nevojshme që kësaj familjeje t'i jepet nga ana e Bashkisë Mirditë një mbështetje financiare për një periudhë 1-vjeçare, në mënyrë që situata ekonomike e kësaj familjeje të lehtësohet.

Konceptoi: Adela Gjikota

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Nr. 776 Prot
DT. 19.02.25



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MIRDITE
NJESIA ADMINISTRATIVE FAN



Fan 14/02/2025

Nr. 52 Prot

RELACION

“VLERËSIM SOCIAL-EKONOMIK I FAMILJES SË Zj. LULJETA LEKË GJOKA”

Luljeta Gjoka është me statusin e ve, pasi para 3 muajsh ka humbur Kryefamiljarin aksidentalisht në punë Mark Ndue Gjoka, duke lenë pas një femijë të mitur, bashkëshorten dhe nënën në moshë të thyer. Bashkëshortja është e semurë dhe e pa aftë për punë. Të ardhura financiare ka vetëm PAK, pasi Luljeta është me probleme shendetësore.

Për arsye të kësaj fatkeqesie që i ka ndodhur kësaj familje, mendojmë që kjo familje të ndihmohet me një ndihmë financiare, sipas mundësive që Bashkia ka në Fuxhet.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë edhe certifikatën familjare.

Konceptoj: Përgj/Nd.Ek. e Sherbimit Social: Arjana LLESHI.

Miratoj: Drejtori Aurel ÇUPI

ADMINISTRATORI

Edmond GJONAJ

